



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

**PËR SHQYRTIMIN E PROPOZIMIT PËR NDRYSHIMIN E VENDIT TË NUMËRIMIT TË
VOTAVE TË ZAZ-SË NR. 53, QARKU ELBASAN, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E
QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30.06.2019.**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 27.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zëvendëskryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e propozimit për ndryshimin e vendit të numërimit të votave të ZAZ-së nr. 53, Qarku Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.323 datë 14.05.2019, ka miratuar caktimin e VNV së KZAZ nr.53 në Ish Kinoklubin e Qytetit, me sipërfaqe 200 m2, Bashkia Prrenjas.

KZAZ nr.53, Bashkia Prrenjas, me shkresën nr. 12475 prot., datë 27.06.2019, të drejtuar KQZ-së dhe Prefektit të Qarkut Elbasan, informon se ambienti i caktuar për VNV nuk i është vënë në dispozicion nga Bashkia Prrenjas.

Kryetarja e Bashkisë Prrenjas, e ka bërë publike kërkesën për të mos vënë në dispozicion të KZAZ nr.53 ambientin e Ish Kinoklubit, në përgjegjësi administrimi, ambient ku administrata zgjedhore, KZAZ-së nr. 53, duhej të ushtronte funksionin publik për përgatitjen e procesit zgjedhor të datës 30.06.2019, kërkesë e adresuar shkresërisht edhe në KQZ.



Nr. 900 i Vendimit Data 27.06.2019 e Vendimit Ora 14:00 e Vendimit

Për shqyrtimin e propozimit për ndryshimin e vendit të numërimit të votave të ZAZ-së nr. 53, Qarku Elbasan,
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019.

Në këto kushte, KZAZ nr. 53, i kërkon KQZ të miratojë caktimin e VNV së ZAZ nr. 53 në Palestrën e Shkollës së Mesme "Halit Bërzeshta", me sipërfaqe mbi 200 m², ku kjo KZAZ po ushtron funksionet e saj.

KQZ, në ushtrim të kompetencave përcaktuar në nenin 21, pika 3, të Kodit Zgjedhor, vlerëson situatën dhe shqyrton propozimin e paraqitur nga KZAZ nr.53.

ZAZ-ja nr. 53 ka në juridiksionin e saj 40 QV, dhe në bazë të përcaktimeve të Udhëzimit të KQZ-së nr. 4, datë 9.04.2015, duhet të ketë sipërfaqe jo më të vogël se 150 m².

Palestrën e Shkollës së Mesme "Halit Bërzeshta", me sipërfaqe mbi 200 m² plotëson kushtet e përcaktuara në Udhëzimin e KQZ nr. 4, datë 09.04.2015 "Për mënyrën e caktimit dhe organizimit të Vendit të Numërimit të Votave, kriteret për caktimin e numrit të Grupeve të Numërimit për çdo Vend të Numërimit të Votave, përcaktimin e rregullave për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupit të numërimit".

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1 germa "a", neni 21, pika 3, nenin 93 dhe 94, pika 1 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar:

V E N D O S I

1. Të caktojë Vendin e Numërimit të Votave të ZAZ-së nr. 53, në Shkollën e Mesme "Halit Bërzeshta", Bashkia Prrenjas.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement ZGURI Kryetar

Denar BIBA Zëvendëskryetar

Bledar SKËNDERI Anëtar

Edlira JORGAQI Anëtare

Rezarta BITRI Anëtare



Nr. 900 i Vendimit Data 27.06.2019 e Vendimit Ora 14:00 e Vendimit

Për shqyrtimin e propozimit për ndryshimin e vendit të numërimit të votave të ZAZ-së nr. 53, Qarku Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019.